

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarve A.L. nga nga Peja për shkak të veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 të KPK-së, dhe B.Sh. nga Presheva, për shkak të veprës penale, ndihma në kryerjen e veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjilan, dhe përgjigje në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.L., av. R.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR në Gjilan, PKR.nr.188/14, të datës 12.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK, më datë 24.05.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan, PKR.nr.188/14, të datës 12.03.2018, vërtetohet.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore - DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.188/14, të datës 12.03.2018, të akuzuarit A.L. dhe B.Sh., bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par.3 të KPPK, i ka liruar nga akuza, dhe atë: të akuzuarin A.L., për veprën penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 të KPK-së, ndërsa, të akuzuarin B.Sh., për shkak të veprës penale, ndihma në kryerjen e veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, me arsyetim se me provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve përmbushen elementet e veprave penale, për të cilat të akuzuarit janë akuzuar me aktakuzë. Për shpenzimet e procedurës penale është vendosur që të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore – DKR në Gjiilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën nuk janë njoftuar fare palët pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktgjykim ku është shqiptuar dënimi me burgim, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/l.nr.184/18, të dt. 25.04.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjiilan, të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet ndërsa çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë dhe përgjigjet në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjiilan, aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë drejtim, duke vepruar kështu konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit në fjalë.

Me ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjiilan, përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, kontestohet mënyra se si janë vlerësuar provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e duke pretenduar kështu se edhe konkludimet e asaj gjykate të nxjerra në bazë të këtyre provave janë të gabuara. Pretendohet se provat në fjalë janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuara dhe se si pasojë e konkludimeve të aprovuara ka rezultuar me shkelje të ligjit Penal në favor të akuzuarve, për çka gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vepruar kur vendimin e ka marrë, duke konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se të akuzuarit A.L. dhe B.Sh., të kenë kryer veprat penale që me aktakuzë iu vihen në barrë, për arsye se përveç gjatë procedurës hetimore edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor me prova të proceduara pa dyshim që vërtetohet gjendja faktike e përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktakuzës. Më tutje në ankesën e prokurorisë pretendohet se nga deklarata e të dëmtuarve – dëshmitarëve B.M. dhe G.G., vërtetohet se i akuzuari A.L., ka bërë organizimin e udhëtimit të dëmtuarve për në vendet e perëndimit dhe atë për në Austri, e që këtë e ka bërë edhe me ndihmën e të akuzuarit tjetër B.Sh.. Faktet dhe rrethanat në fjalë, pra, gjithherë sipas pretendimeve ankimore i ka vërtetuar konkretisht dëshmitari B.M., i cili deklaroi se për të arritur në Austri, të akuzuarit A.L., i ka dhënë shumën prej 1.000 € dhe atë për secilin të dëmtuar nga 300 €, fakte këto dhe rrethana që vërtetohen edhe me deklaratat e të akuzuarve, por, që të njëjtit e mohojnë veprën penale që iu vihet në barrë, vetëm për t'iu shmangu përgjegjësisë penale, prandaj, propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shpall fajtor për veprat penale sipas aktakuzës së prokurorisë apo ta anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cekura si më lartë, nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë, provat e proceduara i ka vlerësuar në përputhje me dispozitat e nenit 361 të KPPK-së, kështu që drejtë i ka vlerësuar dhe analizuar faktet vendimtare, përkitazi me këtë në këtë çështje penalo-juridike në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës edhe i ka liruar të akuzuarit

nga akuza, për shkak të veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 të KPK-së, të akuzuarin A.L., ndërsa, për të akuzuarin B.Sh., për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Në rastin konkret, në këtë çështje penale – juridike, me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se të dëmtuarit B.M., P.E. dhe G.G., së bashku me të akuzuarin A.L., kishin vendosur që të udhëtonin jashtë Kosovës dhe atë më parë kanë shkuar nga Peja në Gjilan, ku aty pasi nuk gjejnë autobus, të njëjtit aty pari e takojnë të akuzuarin B.Sh., me të cilin arrijnë marrëveshje që t'i dërgojë me automjetin e tij nga Gjilani për në Bujanoc, për çka, të njëjtit janë pajtuar që për këtë udhëtim të akuzuarit B.Sh. t'ia paguajnë shumën prej nga 30 €. Po ashtu, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se të dëmtuarit së bashku me të akuzuarin A.L., i kanë kërkuar të akuzuarit B.Sh. që i njëjti me automjetin e tij t'i dërgojë të dëmtuarit për në Beograd, mirëpo, pasi që nuk arrijnë të pajtohen për çmimin atëherë të dëmtuarit pajtohen që i akuzuari B.Sh., të dëmtuarit dhe të akuzuarin A.L., t'i dërgojë vetëm deri në Bujanoc të Serbisë, ku përkritazi me këtë i akuzuari nga të njëjtit ka kërkuar që me vete të kenë dokumentet legale – pra, letërnjoftimet, ngase, kalimi i kufirit nuk mund të bëhet pa dokumente publike – të letërnjoftimeve në pikën kufitare – zyrtare “Dheu i Bardhë” dhe se për këtë transport do të paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 20 , kuptohet në emër të çmimit të transportit. Po ashtu, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se me të arritur në pikën kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë, te vendi i quajtur “Dheu i Bardhë”, pasi bëhet kontrollimi i të dëmtuarve dhe identifikimi i të njëjtëve përmes dokumenteve legale – letërnjoftimeve, pasi policia zbulojë se për njërin nga të dëmtuarit kishte urdhër arrest nga Gjykata e Kosovës, për ekzekutimin e dënimit të shqiptuar me burgim, në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet dhe pas dyshimeve se të njëjtit do të largohen nga Kosova për në vendet e perëndimit, organet kufitare të njëjtit i kanë kthyer dhe nuk i kanë lejuar që të vazhdojnë më tutje, pra, që ta kalojnë kufirin Serbi-Kosovë.

Ndërsa, përkritazi me faktet kontestuese, se i akuzuari A.L., a ishte organizator i udhëtimit të dëmtuarve për në vendet e perëndimit, gjykata e shkallës së parë, përkritazi me këtë, përveç fakteve dhe rrethanave të konstatuara më lartë, mori parasysh edhe deklaratat e të dëmtuarit G.G., i cili ka vërtetuar se ditën kritike të gjithë së bashku kanë vendosur të udhëtojnë për në shtetet e perëndimit dhe se për këtë me të akuzuarin A.L., nuk kanë bërë kurrfarë marrëveshje të posaçme për pagesë, mirëpo, për këtë, pra, para se të vendosin të udhëtojnë ka biseduar me një person të quajtur G.P., për të cilin nuk ka informata më të detajuara, por që personi në fjalë ka qenë duke banuar në Beograd, fakte këto dhe rrethana që i ka vërtetuar edhe dëshmitari B.M., i cili ka mohuar në mënyrë kategorike se i akuzuari A.L., u ka kërkuar para për të udhëtuar jashtë Kosove, gjë që të njëjtën gjë e ka thënë edhe në deklaratën para policisë, por, që atëherë ka konfirmuar se paratë gjatë udhëtimit nuk i ka bartur vetë personalisht, ngase, e ka ditur se është duke u kërkuar nga gjykata për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe është frikuar se do të ndalohet nga policia dhe pastaj do t'i merreshin edhe paratë. Ndërsa, përkritazi me të akuzuarin B.Sh., asnjëri nga të dëmtuarit, por as vetë të akuzuarit, nuk i mohojnë faktet dhe rrethanat se me të njëjtin janë pajtuar që t'i transportojë me automjetin e tij taksit nga Gjilani për në Bujanoc, dhe atë për shumë të parave nga 30 €, për secilin të dëmtuar dhe se marrëveshja ka qenë se kufiri do të kalohet në mënyrë të rregullta e me dokumente legale dhe për vazhdimin e rrugës më tutje me të njëjtin nuk ka pasur kurrfarë marrëveshje e as që e kanë njoftuar se të njëjtit do të vazhdojnë për në vendet e perëndimit, ndërsa, për vazhdimin e rrugës për Beograd, pasi që nuk janë marrë vesh për çmim, i akuzuari B.Sh. iu ka sugjeruar se më lirë e kanë të udhëtojnë me autobus për në Beograd.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, gjegjësisht faktet jo kontestuese, që u cekën më lartë, pastaj se me asnjë fakt apo rrethanë nuk vërtetohet se të akuzuarit A.L. dhe B.Sh., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm t'i kenë mundësuar të dëmtuarve hyrjen e paligjshme në shtetin tjetër – pra, të Serbisë, ngase, si u vërtetua më lartë, të dëmtuarit përmes përdorimit të dokumentacionit legal janë paraqitur në pikën kufitare – zyrtare për ta kaluar kufirin për në Serbi, pastaj, se për këtë – pra, për kalimin e kufirit në fjalë, asnjëri nga të akuzuarit nuk ka përfituar kurrfarë dobie pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ku me asnjë provë nuk vërtetohet se të akuzuarit A.L., të dëmtuarit t'i kenë dhënë

shuma të caktuara të parave, apo që kanë pasur marrëveshje me të njëjtin që t'ia japin parat pasi të arrijnë në vendet e perëndimit, ndërsa, i akuzuari B.Sh., të dëmtuarve iu ka marrë para vetëm shumat e caktuara prej 30 €, në emër të transportit për taksit nga Gjilani për në Bujanoc dhe atë për secilin veç e veç dhe se për kalimin e pikës kufitare janë përdorur dokumente të rregullta, prandaj, me të drejtë edhe është konkluduar nga gjykata e shkallës së parë, se me veprimet e të akuzuarve nuk përmbushen elementet objektive e as subjektive të veprave penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 të KPK-së, dhe ndihma në kryerjen e veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 170 par. 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, çka, nuk ka as shkelje të ligjit penal në favor të akuzuarve, sikur që pretendohet në ankesë, kur të akuzuarit janë liruar nga akuza e prokurorisë.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që me aktakuzë u vihen në barrë, ngase përveç, pretendimeve në aktakuzë, se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që u vihen në barrë, me asnjë provë në shkresë të lëndës por as tani me ankesë, prokuroria nuk ka ofruar prova që do të argumentonte një gjë të tillë, atëherë pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore – DKR në Gjilan, se të akuzuarit është dashur të shpallen fajtorë për këto vepra penale, qartazi janë të pa bazuara e pa mbështetje në prova dhe në shkresë tjera të lëndës.

Nga çka u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.195/2018, të dt. 24.05.2018**

**Procesmbajtësi,**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**1.Xhevdet Abazi**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Fillim Skoro**

\_\_\_\_\_  
**2. Abdullah Ahmeti**  
\_\_\_\_\_